


Indeksi i Çmimeve të Importit

Tremujori II, 2025

Tiranë, më 04 Shtator: Indeksi i Çmimeve të Importit, në tremujorin e dytë të vitit 2025, arriti 107,6 kundrejt vitit 2021 si periudha bazë. Krahasuar me tremujorin e dytë 2024, indeksi i çmimeve të importit shënoi një ulje me 0,7 %, një vit më parë ky ndryshim ishte -1,0 %. Ndryshimi tremujor i indeksit të çmimeve të importit në tremujorin e dytë 2025, krahasuar me tremujorin e parë 2025 ka një ulje prej 0,1 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit sipas tremujorëve



Ndryshimi vjetor: Krahasuar me tremujorin e dytë 2024, çmimet e importit të produkteve në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri kondicionuar” shënuan ulje me 5,3 %, pasuar nga seksionet “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 2,2 %, “Industria përpunuese” me peshën më të madhe prej 94,0 %, me 0,4 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese” ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktiviteteve “Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi” me 1,2 %, pasuar nga “Përpunimi i produkteve ushqimore” dhe “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre” me 0,9 % secili, etj. Nga ana tjetër, seksioni “Industri nxjerrëse” shënoi një rritje me 0,1 %.

Ndryshimi Tremujor: Krahasuar me tremujorin e parë 2025, çmimet në seksionin “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” shënuan ulje me 0,6 %, pasuar nga seksionet “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” me 0,5 %, “Industria përpunuese” me 0,04 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese”, ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre” me 0,5 %, pasuar nga “Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë”, etj. Nga ana tjetër, seksioni “Industri nxjerrëse” shënoi një rritje me 0,1 %.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Indeksi tremujor i Çmimeve të Importit](#)

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Importit mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas,

INSTAT llogarit dhe publikon:

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev.2) në nivel 2-shifror. Duke filluar nga tremujori i parë 2024 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Importit ka si periudhë referuese vitin 2021 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korrente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1).

Për llogaritjen e indeksit përdoret formula si më poshtë:

$$I_{korrent}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum^{Dec} I_{Y-1,Dec}^{Y,M}} + \prod_{Y=viti \text{ baz ë}}^{y-1} I_{Y-1,Dec}^{Y,M} * I_{y-1,Dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin bazë.

- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor të vitit të mëparshëm deri në periudhën y-1.

- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe tremujorit të mëparshëm.